

KMSHC



linfo@kmshc.al



www.kmshc.al



“

E drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit.

Neni 4, pika 1, e Kushtetutës së RSH

Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik.

Neni 15, pika 1, e Kushtetutës së RSH

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL



Rruga "Abdi Toptani", ish Hotel
"Drini", Tiranë

KU TË ANKOHEM PËR SHKELJEN E TË DREJTAVE TË NËPUNËSIT CIVIL?



E DREJTA PËR TU ANKUAR

Realizimi i i së drejtës së ankimit është një e drejtë kushtetuese e subjekteve të së drejtës, e si të tillë, edhe e nëpunësve civilë.

Sipas Kodit të Procedurave Administrative të RSH (referuar shkurtimisht si KPA), neni 134, pika 1 e tij, ankimi ndaj një akti administrativ mund t'i drejtohet organit publik që:

- a. ka nxjerrë ose ka kompetencë të nxjerrë aktin administrativ;
- b. organit publik epror të organit që ka nxjerrë ose ka kompetencë të nxjerrë aktin;
- c. një organi tjetër publik të përcaktuar shprehimisht në ligj.

A MUND TË ANKOHEM PRANË KOMISIONERIT PËR SHKELJEN E TË DREJTAVE?

Sipas nenit 11, pika 1 dhe 14 , pika 1, të ligjit nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar (referuar shkurtimisht si LSHC), Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil është përgjegjës për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil.

Komisioneri e ushtron këtë kompetencë në dy nga mënyrat e mëposhtme:

- a. kryesisht (me iniciativën e vetë institucionit), sipas planit vjetor të punës të hartuar në fund të çdo viti në bazë të riskut që paraqesin subjektet, plan i cili është objekt ndryshimi, për shkak të rrethanave të reja që kërkojnë ndërhyrjen e Komisionerit, të cilat çmohen rast pas rasti prej tij;
- b. me kërkesë të institucioneve.

Në kuptim të dispozitave të KPA dhe LSHC, të cituara këtu, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil nuk është organ që ka për kompetencë zgjidhjen e ankesave të nëpunësve civilë.

CILI ËSHTË MJETI EFEKTIV I ANKIMIT QË MË NJEH LIGJI PËR SHËRBIMIN CIVIL?

Në bazë të nenit 41 të LSHC, çdo nëpunësi civil ka të drejtë të ankohet në gjykatën kompetente për mosmarrëveshjet administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi, që i cenon të drejtat dhe interesat e tij të ligjshme në marrëdhënien e shërbimit civil.